

Në bazë të nenit 19, paragrafi 1, pika 7, nenit 11 paragrafi 1, pika 5 të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 38/96-64/18), neni 26 paragrafi 1 alineja 4 të Statutit të NP "Parqe dhe gjelbërime", Këshilli Drejtues i NP "Parqe dhe gjelbërime", në seancën e mbajtur më datën 07.12.2018, solli

## **VENDIM**

### **për miratim të Çmimoreve për rregullim të sipërfaqeve të gjelbëruara publike me pajisje urbane**

#### **Neni 1**

Miratohet Çmimorja për rregullim të sipërfaqeve të gjelbëruara publike me pajisje urbane e NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup.

#### **Neni 2**

Detyrohen shërbimet profesionale për realizimin e këtij vendim.

#### **Neni 3**

Me miratimin e kësaj Çmimore, shfuqizohen Çmimorja për ndërtim të objekteve përcjellëse në suaza të gjelbërimit publik me nr. 02-3136/1 e datës 03.11.2011, Ndryshimi dhe plotësimi me nr. 02-2169/2 i datës 30.06.2014 dhe Çmimorja për përgatitje dhe rikonstruksion të pajisjeve urbane në suaza të sipërfaqeve të gjelbërimit publik me nr.02-2169/9 e datës 30.06.2014.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit, dhe i njëjti dhe Çmimorja do të zbatohen pas marrjes së pëlqimit nga ana e Këshillit të Qytetit të Shkupit.

#### *Arsyetim*

Për shkak të vëllimit të zmadhuar të aktiviteteve të punës dhe ndërtimit të pajisjeve të ndryshme urbane në suaza të gjelbërimit publik, shërbimet profesionale dhe drejtori i propozuan ndryshimet e çmimoreve, me shtimin e llojeve të reja të pajisjeve urbane, dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike, u miratua vendimi sikur në diapozitivin. Çmimet e përcaktuara do të zbatohen pas marrjes së pëlqimit nga ana e Këshillit të Qytetit të Shkupit.

#### **Dorëzuar deri te:**

- arkivi
- drejtori
- këshilli drejtues
- shërbimet profesionale
- Këshilli i Qytetit të Shkupit

**NP "PARQE DHE GJELBËRIME"**  
**KËSHILLI DREJTUES**  
**Kryesuesi,**

-----